



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:093815
Datë: 16.07.2024
Numri i dokumentit: 05944069

C.nr.279/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.H, A.S, M.M, R.K, H.C, E.D, E.R.D, të gjithë nga Rahoveci, të cilët i përfaqëson Av. A.M, nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O, nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 4,458.00 euro, jashtë seancës, më datën 16.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.H, A.S, M.M, R.K, H.C, E.D, E.R.D, të gjithë nga Rahoveci.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses F.H, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 352 ditë pune të ja paguajë shumën prej 704,00 euro, duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 20.04.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.S, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 20.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 258 ditë pune të ja paguajë shumën prej 516,00 euro, duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 20.04.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit M.M, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 303 ditë pune të ja paguajë shumën prej 606,00 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 20.04.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses R.K, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 29.03.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 299 ditë pune të ja paguajë shumën prej 598,00 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 20.04.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

- të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit H.C, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 382 ditë pune të ja paguajë shumën prej 764,00 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 20.04.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- VII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses E.D, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 29.03.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 311 ditë pune të ja paguajë shumën prej 622,00 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 20.04.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses E.R.D, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 324 ditë pune të ja paguajë shumën prej 648,00 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 20.04.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- IX. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve F.H, A.S, M.M, R.K, H.C, E.D, E.R.D, t’i paguajë shumën prej 354,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit F.H, A.S, M.M, R.K, H.C, më datën 20.04.2023, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë.

Paditësit F.H, A.S, M.M, R.K, H.C, janë mësimdhënës pranë SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec, dhe janë në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit. Periudha e kërkuar sipas precizimit të kërkesëpadisë është nga data 01.01.2021, e deri më datën 21.11.2022 dhe atë për 352, 258, 303, 299, 382, 311, si dhe 324, ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 21.08.2023, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se paditësve kanë ushtruar padi në gjykatë më 20.04.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 22.01.2021, e deri më datën 21.11.2022, me mbështetje në

Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017. Padiësve, referuar Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017, me kërkesëpadi kanë kërkuar kompensim përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, ngase KKAK e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri më 21.01.2021. Nga kjo rezulton qartë se nuk mund të kërkoet kompensim për periudhën përtej vlefshmërisë së kontratës. ashtu që kërkesëpadi e padiësit qartazi është përfshirë në parashkrim, ngase kanë kaluar më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi e kontratës në të cilën padiësit janë thirrur, e tërë kjo konform nenit 87 të Ligjit të Punës i Kosovës. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e padiësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës me nr. të prot. 67/20, të datës 14.09.2020; kontratën e punës me nr. të prot. 59/15, të datës 01.09.2015; kontratën e punës me nr. të prot. 168/16, e datës 01.09.2016; kontratën e punës me nr. të prot. 100/15, të datës 01.09.2015; kontratën e punës me nr. të prot. 19/15, të datës 01.09.2015; kontratën e punës me nr. të prot. 69/15, të datës 01.09.2015; kontratën e punës me nr. të prot. 70/15, të datës 01.09.2015; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 222/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 223/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 224/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 226/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 226/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 225/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 227/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 228/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec;.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se padiësit kanë pasur të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se padiësit për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon padiësve pagesa e ushqimit dhe udhëtimit për çdo ditë të prezencës në punë, a ka legjitimitet real pasiv e paditura, dhe në parashkrim të kërkesës.

Me administrimin e kontratës së punës me nr. të prot. 67/20, të datës 14.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe padiësës F.H, gjykata vërtetoi faktin se padiësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec.

Me administrimin e kontratës së punës me nr. të prot. 59/15, të datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe padiësës A.S, gjykata vërtetoi faktin se padiësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec.

Me administrimin e kontratës së punës me nr. të prot. 168/16, të datës 01.09.2016, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe paditësit M.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec.

Me administrimin e kontratës së punës me nr. të prot. 100/15, të datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe paditëses R.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec.

Me administrimin e kontratës së punës me nr. të prot. 79/15, të datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe paditësit H.C, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec.

Me administrimin e kontratës së punës me nr. të prot. 69/15, të datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe paditëses E.D, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec.

Me administrimin e kontratës së punës me nr. të prot. 70/15, të datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe paditëses E.R, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 222/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësja F.H në periudhën kohore 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 352 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 223/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.S në periudhën kohore 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 258 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 224/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi M.M në periudhën kohore 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 303 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 226/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Isa Boletini”, në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi H.C në periudhën kohore 01.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 382 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 225/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. "Isa Boletini", në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësja R.K në periudhën kohore 29.03.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 299 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 227/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. "Isa Boletini", në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësja E.D në periudhën kohore 29.03.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 311 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 228/23 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. "Isa Boletini", në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësja E.R.D në periudhën kohore 18.04.2020 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 304 ditët e punës.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditësi në periudhën kohore nga data 01.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tyre të punës kanë prezantuar në 352, 258, 303, 299, 382, 311, 324 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësit kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*". Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që "*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore*". Në rast se shumëzohen 352 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 704.00 euro. Në rast se shumëzohen 258 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 516.00 euro. Në rast se shumëzohen 303 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 606.00 euro. Në rast se shumëzohen 299 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 598.00 euro. Në rast se shumëzohen 382 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 764.00 euro. Në rast se shumëzohen 311 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 622.00 euro. Në rast se shumëzohen 324 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 648.00 euro.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 20.04.2023, ndërsa kërkesëpadia e paditësit është për periudhën nga data 01.01.2021 e deri më datën 21.11.2022. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit "*Të gjitha kërkesat nga*

marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.*

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (20.04.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”,* në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që paditësve t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën IX të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 354.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 312.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro, diferencë në taksë 21.00 euro

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.279/2023, më datën 16.07.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.